

**MBI AKTIVITETIN
E KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR
DHE ZHVILLIMET NË REFORMËN
PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN
DHE SUNDIMIN E LIGJIT**



**KPP – Buletin periodik 05
Tetor 2024**



**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

Takim me ambasadorët e vendeve të BE në Tiranë

Ambasadori i BE-së, z. Silvio Gonzato ftoi Kryetarin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit, në një takim pune me trupën diplomatike të ambasadorëve të 27 vendeve anëtare të Bashkimit Europian në Tiranë. Takimi u zhvillua në mjediset e “Europe House”. Në këtë takim së bashku me z. Xhafaj merrte pjesë edhe z. Toni Gogu, anëtar i këtij komisioni.

Ambasadori Gonzato, si mikpritës dhe organizator i takimit, si bëri një prezantim të Komisionit dhe pritshmërive ndaj tij në kuadrin e procesit të negociatave me BE-në, theksoi domosdoshmërinë për të ndërtuar një proces sa më gjithëpërfshirës dhe transparent. Kreu i Delegacionit të BE-së në Tiranë, vlerësoi rolin e këtij komisioni dhe theksoi nevojën për të forcuar përfshirjen dhe besimin e qytetarëve dhe grupeve të interesit në këtë proces transformues.

Kryetari i Komisionit, pasi bëri një prezantim të vizionit, qëllimeve dhe synimeve që Kuvendi kërkon të realizojë përmes Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit, për qasjen dhe metodologjinë e punës së Komisionit dhe më pas i informoi ambasadorët e BE-së mbi ecurinë e deritanishme të këtij procesi.

Z. Xhafaj ndër të tjera theksoi: “Ky projekt është vazhdim i përpjekjeve për modernizimin e shtetit, për reformimin e institucioneve të tij. Ambicia jonë është e qartë: ne duam t’i japim vendit një reformë tjetër të rëndësishme pas reformës në sistemin e drejtësisë. Ne reformuam drejtësinë, por e kemi domosdoshmëri reformimin e institucioneve të tjera të shtetit me të njëjtën frymë dhe me të njëjtat standarte për të ecur me të njëjtin ritëm. Ne kemi të njëjtin synim dhe ambicie edhe me këtë reformë: të përballemi me këto sfida, të reformojmë një sërë institucionesh ligjbërëse dhe ekzekutive për t’i sjellë ato në të njëjtin standard me drejtësinë, me standartet europiane. Besojmë se kjo reformë do ta bëjë më të lehtë dhe më të shpejtë rrugën tonë drejt anëtarësimit në BE. Para së gjithash kjo është një reformë për vendin, për qytetarin, në themel të së cilës qëndron interesi i lartë publik se si ta modernizojmë shtetin në të gjithë strukturën e tij, si ta bëjmë qeverisjen më të mirë në të gjitha nivelet, më të drejtë, më llogaridhënëse dhe më të hapur për qytetarin. Kryesorja është që shoqëria dhe institucionet e saj në të gjitha nivelet e në të gjithë territorin të reagojnë e të përballen shumë më mirë se deri tani me fenomenin e korrupsionit, që është ende një fenomen aktiv në shumë sektorë, dhe të forcohet më tej sundimi i ligjit. Duke u përballur me këto sfida, që e bëjnë shtëpinë tonë, vendin tonë më të mirë, natyrisht që ne bëhemi më të mirë dhe e bëjmë më të lehtë dhe më të shpejtë rrugën tonë për t’u bërë pjesë e familjes europiane.”

Më tej ai theksoi: “Ne e konsiderojmë reformën në drejtësi një prej lëvizjeve më të mëdha shtetndërtuese në historinë e shtetit shqiptar, më të madhen në procesin historik të kalimit nga diktatura në një demokraci funksionale.

Zbatimi i saj mbetet një domodoshmëri për jetësimin e parimit themelor kushtetues të ndarjes dhe balancimit ndërmjet tri pushteteve si dhe për të garantuar një sistem drejtësie të pavarur, të përgjegjshëm, llogaridhënës, transparent, eficient, profesional dhe të barabartë për të gjithë qytetarët. Shtyllat e reformës në drejtësi, të miratuara në vitin 2016, janë të panegociueshme.

Ne vlerësojmë rezultatet e derisotme pozitive të reformës në drejtësi, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit nëpërmjet procesit të vetingut për pastrimin e burimeve njerëzore në sistemin e drejtësisë dhe nëpërmjet veprimtarisë së Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e cila po kontribuon në mënyrë domethënëse në dhënien fund epokës së pandëshkueshmërisë.

Ne synojmë të garantojmë pakthyeshmërinë e reformës në drejtësi, konsolidimin e saj të mëtejshëm dhe rritjen e eficiencës së sistemit të drejtësisë në pritshmëritë e qytetarëve shqiptarë, nxitjen e cilësisë së vetëqeverisjes së sistemit të drejtësisë nëpërmjet forcimit të integritetit, llogaridhënies dhe transparencës sipas rekomandimeve të raporteve të BE-së dhe masave të udhërrëfyesit *'Për shtetin e së drejtës'* në zbatim të tyre."

Diskutimet në takim u fokusuan kryesisht te roli i Komisionit të Posaçëm, te pritshmëritë e reformës dhe angazhimi i ekspertëve vendas e të huaj. Ambasadorët shprehën mbështetjen për këtë nismë të Kuvendit të Shqipërisë, vlerësuan punën e deritanishme të Komisionit dhe theksuan domosdoshmërinë për një bashkëpunim ndër-institucional, rëndësinë e një reforme gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, që do të avancojë vendin tonë në rrugën drejt integritetit në BE.

Z. Xhafaj dhe z. Gogu në përgjigjet e pyetjeve të bëra nga ambasadorët i informuan ata për axhendën e punës së Komisionit, për gjithëpërfshirjen, transparencën, profesionalizmin dhe ekspertizën ndërkombëtare në veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar si dhe për hapat në vazhdim për hartimin e Dokumentit Analitik dhe Planit Kombëtar të Veprimit. Ata gjithashtu nënvizuan angazhimin për t'i kushtuar vëmendje ruajtjes së ekuilibrave kushtetues si dhe koherencës me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE, përfshirë parimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe të pakthyeshmërisë së reformës në drejtësi të vitit 2016.

Ambasadorët e vendeve të BE-së (i Francës, i Gjermanisë, i Italisë, i Suedisë dhe i Çekisë) vlerësuan rëndësinë e këtij projekti ambicioz të inicuar dhe realizuar nga vetë autoritetet shqiptare dhe theksuan rëndësinë e përmbushjes së afateve dhe sigurimin e një procesi gjithëpërfshirës. Ambasadori i Spanjës mbështeti rëndësinë e kësaj reforme për vendin dhe solli për të pranishmit në takim përvojën e vendit të tij në këtë drejtim, ndërsa ambasadori i Holandës theksoi rëndësinë e llogaridhënies institucionale dhe të përfshirjes së opozitës në këtë proces.

Të gjithë të pranishmit vlerësuan rëndësinë e këtij takimi informues dhe ranë dakord për ta vazhduar këtë komunikim në takime të tjera të ngjashme në të ardhmen.

Takime me ambasadorët e Gjermanisë, OSBE-së dhe Bankës Botërore si dhe me ekspertë ndërkombëtarë

Edhe rgjatë muajit tetor kryetari i Komisionit të Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit dhe disa anëtarë të Komisionit zhvilluan takime me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare në Shqipëri. Me ambasadorin e OSBE-së në Tiranë, z. Michel Tarran, diskutuan mbi punën e deritanishme të Komisionit të Posaçëm. Ai nënvizoi angazhimin e OSBE-së në luftën kundër korrupsionit dhe vlerësoi transparencën e procesit.

Një tjetër takim ishte ai me ambasadorin e Gjermanisë në Tiranë, z. Karl Bergner, i cili gjithashtu çmoi përpjekjet e Komisionit për një reformë gjithëpërfshirëse, domosdoshmërinë e përfshirjes së opozitës në të dhe ritheksoi mbështetjen e Gjermanisë për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Një bashkëbisedim me shumë interes ishte edhe ai i deputeteve Milva Ekonomi dhe Etilda Gjonaj, anëtare të Komisionit të Posaçëm, me drejtuesit e Misionit të Bankës Botërore. Përfaqësuesit e Bankës Botërore vlerësuan rëndësinë e shumanshme të kësaj reforme për zhvillimin ekonomik e social të vendit dhe e konsideruan atë një reformë ambicioze dhe të nevojshme për procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Njëherësh ata konfirmuan mbështetjen e tyre me asistencë teknike për këtë reformë dhe angazhimin e 6 ekspertëve të tyre në këtë proces, nga dy për secilën shtyllë.

Ekspertët hartojnë draftin e parë të Dokumentit Analitik

Gjatë muajit Tetor, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariati Teknik, të angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit, kanë finalizuar punën për hartimin e një drafti të parë të Dokumentit Analitik, i cili bën vlerësimin/analizën e situatës aktuale në fushën e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit. Ekspertët e Nivelit të lartë, të ndarë në nëngrupe, zhvilluan një sërë takimesh për të hartuar dhe diskutuar rreth draftimit të Dokumentit Analitik. Drafti i parë i analizës së situatës aktuale në të 3 fushat: Mirëqeverisja, Antikorrupsioni dhe Sundimi i Ligjit, mbështetet kryesisht në vlerësimet, gjetjet dhe rekomandimet e shprehura në Raportet e BE-së, si dhe në një sërë raportesh e dokumentash të tjera zyrtare, vendase dhe ndërkombëtare.

Konferencë për mediet, pyetje-përgjigje për punën e Komisionit të Posaçëm

Gjatë këtij muaji u organizua një bashkëbisedim me përfaqësues të medias për t'i njohur ata punën e bërë nga Komisioni i Posaçëm dhe Grupi i Ekspetëve të Nivelit të lartë, hapat që do të ndërmerren më tej, si dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre lidhur me çështje të caktuara objekt pune të Komisionit të posaçëm. (Për më shumë vizitoni faqen ueb të Komisionit www.masl.al.)

Transparenca, bëhet publike faqja në Web e Komisionit të Posaçëm

Gjatë konferencës për mediet kryetari i Komisionit të Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit, z. Fatmir Xhafaj, prezantoi edhe faqen web të Komisionit. **MASL.al** është një hapësirë e dedikuar *on-line* për të bërë transparencën e plotë të punës, për të dokumentuar të gjithë veprimtarinë, vendimet dhe dokumentet që do të prodhohen nga Komisioni gjatë mandatit të tij. Përveçse një arkiv digjital kjo faqe është gjithashtu edhe një platformë për përfshirjen e publikut të interesuar. **MASL.al** është konceptuar si një faqe dinamike, që synon të ketë edhe ndërveprim të lartë me publikun dhe përfshirje të personave të ndryshëm që duan të kontribuojnë. Në hapësirën “Konsultim me publikun” ka rubrika të veçanta për të pyetur ekspertët dhe anëtarët e Komisionit, për të zhvilluar anketime të ndryshme dhe për konsultimin e çështjeve e nismave ligjore që do të dalin gjatë punës së Komisionit të Posaçëm. Po kështu do të publikohen thirrjet e Komisionit për pjesëmarrjen e grupeve të interesit dhe të publikut në tërësi. Cilido që është i interesuar të regjistrohet ka një hapësirë *on-line* për të marrë në mënyrë periodike publikimet dhe përditësimet.

Publikohen Përmbledhjet Ekzekutive të draft Dokumentit Analitik

Në faqen ueb të Komisionit të Posaçëm janë publikuar përmbledhjet ekzekutive të draftit të Dokumentit Analitik për çdo shtyllë të punës së Komisionit. Materialet janë të aksesueshme nga cilido që është i interesuar. Ato kanë për autorë ekspertët e nivelit të lartë të propozuar nga institucionet e pavarura, universitetet, shoqëria civile dhe organizatat e biznesit. Këto përmbledhje do të prezantohen dhe debatohen në tryeza tematike publike, me qëllim pasurimin e Dokumentit Analitik, i cili në fund do t'i paraqitet Komisionit të Posaçëm për miratim.

Komisioni i Posaçëm në mbledhjen e radhës miratoi 3 vendime lidhur me: i) procesin e konsultimit publik, ii) përbërjen e GENL-së dhe ii) listën e ekspertëve të jashtëm

Në mbledhjen e radhës Komisioni i Posaçëm mori vendime të natyrës përgatitore dhe organizative si më poshtë:

1. Miratimi i hapave për organizimin e konsultimit publik sipas masave të propozuara nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariati Teknik, ku përfshihen:

i) organizimi i rreth 12 tryezave tematike publike;

ii) organizimi i rreth 10 forumeve të dialogut qytetar me fokus çështjet e ndjeshme për qytetarët;

iii) organizimi i konsultimeve me grupet e interesit, përfshirë institucionet shtetërore dhe agjencitë ekzekutive ligjzbatuese;

iv) konsultimi i draftit të Dokumentit Analitik me ekspertë dhe konsulentë ndërkombëtarë për të marrë vlerësimet dhe komentet e tyre lidhur me përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare, si dhe për të reflektuar përvojat më të mira ndërkombëtare në këto fusha.

2. Miratimi i ndryshimeve në përbërjen e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë.

3. Miratimi i listës së ekspertëve dhe konsulentëve të jashtëm ndërkombëtarë që do të atashohen pranë Komisionit për të mbështetur dhe kontribuar në përmbushjen e objektit të veprimtarisë së tij.

Çfarë pritet të ndodhë gjatë muajit nëntor me agjendën e Komisionit?

Me qëllim përmbushjen e parimeve kryesore mbi të cilat është ndërtuar puna e Komisionit të Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit dhe gjithë procesi reformues që ai synon të realizojë, gjatë muajit nëntor do të zhvillohen rreth 12 tryeza tematike publike për një sërë çështjesh të përcaktuara nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, të cilat synojnë: *gjithëpërfshirjen, transparencën, profesionalizmin dhe arritjen e standarteve më të mira të BE-së.*

Moderimi dhe prezantimi i çështjeve të shtruara për debat dhe konsultim publik do të bëhen nga vetë ekspertët që kanë punuar me to. Në këto tryeza do të ftohen të marrin pjesë grupet e interesit, institucionet ligjzbatuese, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të komunitetit të biznesit, profesionistë të fushës etj.

Gjatë muajit nëntor do të punohet për organizimin e forumeve të dialogut qytetar, me fokus çështjet e ndjeshme për qytetarët si dhe zhvillimi i konsultimeve me grupet e interesit, përfshirë institucionet shtetërore, agjencitë ekzekutive ligjzbatuese dhe ekspertë e konsulentë ndërkombëtarë.

Me mbështetjen e ekspertizës ndërkombëtare, gjatë muajit nëntor 2024 do të punohet me Grupin e Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariatit Teknik për përgatitjen e konceptidesë lidhur me hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar



KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

**“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**